

Bazuar në nenin 10 paragrafi 1 dhe paragrafi 6 i Rregullores për punën e Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale (tekst i pastruar) nr.01-3732/1 nga 29.07.2019, Këshilli i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale në seancën e 21-të mbajtur më 27.05.2022, në lidhje me Propozimin nr 03-2078/2 nga 25.05.2021 për marrjen e procedurës kundërvajtëse ndaj SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçov për shkelje të nenit 51 paragrafi 1 nga LSHMAAV, miratoi si më poshtë:

K O K L U Z Ë

1. Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore administrative nr.10-2078/1 nga 20.05.2022 ndaj SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçov dhe përcaktoi shkelje të nenit 51 paragrafi 1 nga LSHMAAV.

2. Këshilli i Agjencisë ndaj SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçov vendosi të inicohet procedurë kundërvajtëse pranë gjykatës kompetente sepse nga mbikëqyrja u konstatua se transmetuesi i përmendur më 9 maj 2022 nuk i siguroi informacionet të cilat duhet të vihen në dispozicion të përdoruesve, që është në kundërshtim me nenin 51 paragrafi 1 nga LSHMAAV.

3. Obligohet sektori për çështje juridike dhe furnizim publik të përgatisë Kërkesë për marrjen e procedurës kundërvajtëse pranë gjykatës kompetente për transmetuesin e përmendur.

4. Ekzemplar nga konkluzioni t'u dorëzohet:

- Udhëheqësve të sektorve në Agjencion,
- Personit të emëruar në Agjencion, për udhëheqjen e lëndëve në procedurën administrative,
- Sektori për mbështetjen e punës së Këshillit të Agjencisë,
- Sektori për mbështetje informative dhe punë të përgjithshme — arkivi i Agjencisë.

Nr.03-2108/4
27.05.2022
Shkup

Agjencia për shërbime mediatike
audio dhe audiovizuale
Kryetar i Këshillit
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v